



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE PER INVESTIMET E HUAJA,
VENDASE DHE INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 10638 Prot.

Fier, më 19. 09. 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 91, Datë 19. 09 2025

PËR

**“ MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT ME TITULL “ARIADNE” NË
KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar, “, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “*Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore*” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull “**ARIADNE**”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, Ekzekutivi i Bashkisë Fier,

PROPOZON:

1. Miratimin për implementimin e projektit me titull “ARIADNE”, në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financuar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi - Republika e Shqipërisë, 2021-2027.

2. Bashkia Fier, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet. Buxheti për Bashkinë Fier është **163.353,94 euro** nga të cilat: **130.683,13 euro** Kontribut i BE dhe **32.670,81 euro** bashkëfinancim i Bashkisë Fier.
3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier, të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Drejtoria e Projekteve te Infrastruktures

Elidon Basha /

Drejtoria Juridike


Esmeralda Kapllanaj

Drejtoria Financë Buxhet dhe Kontabilitet

Pranvera Çina

K R Y E T A R

ARMANDO SUBASHI

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Armando Subashi', is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' at the top and 'BASHKIA FIER' at the bottom, surrounding a central emblem.